



Vendetohet njësia me
originalin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT-V E N D I M

Date ____ / ____ / 2025

Për

“Përcaktimin e kriterëve për dhënien e ndihmes ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike dhe dhënien e Ndhmes Ekonomike për familjet në nevojë nga fondet e Bashkise “

Në mbështetje të nenit 8 , pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronjat a dhe b , nenit 24 , nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV , pikat 2,3 dhe 6, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, të Keshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, Vendimit nr.868, dt.29.12.2021 të K.M. “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.597 dt.04.09.2019, të Keshillit të Ministrave”, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmes ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit nr.68, dt.23.12.2024, të Keshillit Bashkiak “Për miratimin e programit Buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkise Kavaje për vitin 2025” si dhe referuar relacionit përmbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Ndhmes Ekonomike me propozim të Kryetarit të Bashkise z.Fisnik Qosja i paraqet Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e radhës:

TË MIRATOJË

1. Kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% si më poshtë:

- a) Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por që jetojnë në kushtet e varfërisë në banesa të pa përshtatshme.

- b) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe kanë fëmijet në shkollë të moshës nën 18-vjeç, dhe nuk kanë anëtarë madhor të tjerë në punë.
- c) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe njëri nga prindërit është person me aftësi të kufizuar, por fëmijët janë nën moshë pune.
- d) Familjet që refuzohen nga sistemi I pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe k/familjare është nëna, dhe fëmijët janë në shkollë.

2. Kriteret mbi përcaktimin e procedurave, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar (6%) të buxhetit vendor si më poshtë:

- Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar nëpërmjet regjistrimit elektronik për ndihmën ekonomike dhe të cilët nuk janë shpallur fitues nga sistemi I pikëzimit.
- Prioritet do të kenë familjet me nevoja sociale ekonomike ku përfshihen:
 - Familjet të papuna me më shumë se 3 fëmijë nën moshën 18 vjeç,
 - Familjet të papuna me 1 anëtar, (te mos jetë si rezultat I ndarjes nga trangu familjar)
 - Familjet të papuna me një prind, ku kryefamiljare është nëna.
 - Familjet burra e grua me moshe mbi 55 vjeç të pa punë e pa të ardhura.
- Gratë e veja të pa puna me fëmijë nën moshën 18 vjeç.
- Cdo familje në nevojë pa të ardhura e cila nuk plotëson nevojat bazë jetike

3. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond të llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social (Sktori Ndihmës Ekonomike), Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Njësite Administrative të Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

Drejtoria Shërbimit Social
Xhulja Uzuni

Drejtoria Burimeve Ligjore
Adrian Malaj,

Drejtoria e Burimeve Ekonomike

Andi Çungu

Sekretari Keshillit Bashkiak
Meri Biturku

KRYETARI

P/ FISNIK QOSJA

ESTER

